

Data 18.05.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN KORCË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42716000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 107,048,337 (njëqind e shtatë milion e dyzetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) Lekë (pa TVSH), ose 888,221 (tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzetë e një) Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Blerjeve të Përqendruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të tillë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit pra Ak-së . Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi është pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve të kontaminuara të cilat pasi të lahen do të përdoren për shtretërit e pacientëve të sëmure, apo personelit mjekësor, si dhe për sallat e operacioneve ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kyerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit**. Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Vendodhja që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

- Krahas deklarates te paraqes akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Shënim 2.1:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë për ambientin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderia, pra operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient per kryerjen e shërbimit te lavanderise. Për për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të provojnë se disponojnë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

3. Operatori Ekonomike duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues, do të realizoj ambientin për të realizuar shërbimin e lavanderise në ambjentet e Autoritetit Kontraktor sipas percaktimeve ne Specifikimet Teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se në rast se shpallet fitues, do të realizoj lavanderine në ambjentet e Autoritetit Kontraktor, Ky kriter është vendosur nisur nga fakti se shërbimi i lavanderise do te kryhet ne ambjentin e autoritetit kontraktor, e percaktur kjo nga vete Autoriteti Kontraktor dhe për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të deklarojnë realizimin e lavanderise në ambjentet e Autoritetit Kontraktor, me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 11 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik- me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi	1 (një)
Punëtore në Lavanderi	4 (katër)
Punonjës Shërbimi	6 (gjashtë)
Totali i punonjësve	11 (njëmbëdhjete)

- Për Drejtuesin Teknik, me profil - Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi OE duhet te paraqes:
 - Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profil - Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi.
 - Kontrate pune perkatese.
 - Librezë pune

- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e - Albania.
 - Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesipër nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuksi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklarata të perkatese.
 - Drejtuesi nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklarata të perkatese nga Administratori/Drejtuksi Ligjor i shoqërisë.
- Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, të paraqitet vetëm kontrata të pune të perkatese.
 - Për punonjësit punëtor shërbimi, si dhe punëtor ngarkim shkarkimi, të paraqitet vetëm kontrata të pune të perkatese.
 - Operatori ekonomik të paraqes deklarata të lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
----	--------------	------------	---

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat e cdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

***Shënim 4.1:**

Më qëllim garantimit të gjithë përfshirjes, për të dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën të perkatese të prokurimit, punonjësit e mesipër jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Stafi i cili do të paraqitet Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontratës. Për këtë arsye të paraqitet deklarata të perkatese nga Administratori/Drejtuksi Ligjor i shoqërisë.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor, Spitali Memorial Fier, referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbimi i lavandierisë ka përcaktuar një numër minimal punonjësish në funksion të ofrimit të këtij shërbimi nga operatorët ekonomik-. Duke qenë se është kontratë 4 (katër) vjeçare dhe referuar volumit të madh të shërbimit i cili parashikohet të realizohet çdo ditë në këtë spital kërkohet që ofertuesit duhet të vërtetojnë që kanë të punësuar fuqi punëtoresh minimale në sektorin e shërbimit të objektit prokurimi. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar numri i punonjësve sipas profesioneve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve.- Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në nevojën për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit.

5. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makineri larese profesionale per nje kapacitet larese minimalisht prej 40 kg/dite (Duhet te jene prodhime te dhjetevjecarit te fundit).	copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira
2	Makine Hekurose (Rul) Profesionale (mbi dy metra gjatesi)	copë	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
3	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash, per nje kapacitet paketimi minimalisht prej 40 kg/dite (Duhet te jene prodhime te dhjetevjecarit te fundit).	cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
4	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jetë e kalibruar dhe të shoqëruar me akt kolaudimi nga autoritete përkatëse (Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë)	cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
5	Karroca metalike shumekateshe per materialin e bute	Cope	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit, dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe insnturmente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit te dokumentacionit te mesiperm pas publikimit te Njoftimit Fitues do te verifikoj prane ambienteve te operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruar.

Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Pajisjet e kerkuara qe do te deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Është e nevojshme disponimi i mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës dhe konkretisht se disponojnë ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së larjes së materialeve të buta, ambient i cilin duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi provuar ky fakt me paraqitjen e dokumenteve të mësipërme;Duhet të disponojnë makineri e përcaktuara në tabelën e mësipërme të cilat i

ka kërkuar edhe autoriteti kontraktor si pajisje, për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, të vërtetuara me dokumentacion.

6. Operatori ekonomik në lidhje me materialin e bute të percaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i akredituar.

Materialet e Buta			Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
3			
Etj.			

Shënim 6.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Te dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qene pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Me nënshkrimin e kontratës dhe dorëzimin e materialeve të buta operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes pranë AK edhe raport testimet përkatëse për cdo produkt. Për këto të paraqes detyrimisht një deklaratë se cdo produkt do të shpërohet me raportin përkatës i cili duhet të jetë sipas kërkesave / specifikimeve teknike të AK.

Argumentimi: Në lidhje me materialet e buta pjesë e kontratës për objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të garantojë se materialet e buta duhet të jenë sipas standarteve ndërkombëtare dhe të akredituara nga organe kompetente me qëllim përmbushjen me sukses të shërbimit të lavandërisë.

7. Operatori ekonomik në lidhje me materialet e pastrimit që do të përdoren për shërbimin e lavandërisë e percaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i akredituar.

Materialet e pastrimit			Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjinës së produktit të pastrimit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
3			
Etj.			

Shënim 7.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Ne varesi te ndotjes dhe rrezikshmerise qe kane materialet spitalore, operatori ekonomik duhet të garantoj se per sherbimin e lavanderise do te perdor detergjent dhe dizinfektant lares sipas standarteve higjeno -sanitare te certifikuara nga organe te akredituara. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar lloje e materialeve të ndotura qe do te lahen, per te cilen operatori ekonomik duhet te specifikoj vendin e origjines se laresve si dhe akreditimin e saj.

8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate operatori ekonomik duhet të garantoj së shërbimi I lavanderisë do të kryhet sipas standarteve në fuqi me qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 20/06/2022; Ora: 11:00; Vendi: www.app.gov.al, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë.